

**STATUT DHE AKT THEMELIMI**  
**PER KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TË SHOQËRISË**  
**"Ora and Ora" sh.p.k.**

Sot më datë 06/03/2024 u përpilua ky Statut nga ortaku themelues:

1.Znj.Sally Sephora lindur në Britani më 17.10.1976, atësia Ian Stanley, amësia Janet Eileen pajisur me pasaportë me nr. 519435135, banuese në Koplik, Malësi e Madhe madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

I quajtur më poshtë ortaku themelues, i cili në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", krijon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar si vijon:

**KREU I**

**NENI 1**

**FORMA**

Ortaku i mësipërm krijon një *Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar* në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri dhe me dispozitat e këtij Statuti.

**NENI 2**

**EMRI I SHOQËRISË**

Emri i shoqërisë do të jetë "Ora and Ora" Sh.p.k.


**NENI 3**

**SELIA E SHOQËRISË**

Selia qendrore e shoqërisë do të jetë në Koplik, Fshati Kamicë, ZK 2068, Numri i pasurisë 430. Shoqëria ka të drejtë që me vendim të ortakëve të shoqërisë mund të hapë degë, zyra, filiale ose përfaqësi të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

**NENI 4**

**KOHËZGJATJA**



Shoqëria do të ketë kohëzgjatje të papërcaktuar. Si datë fillestare merret data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### **NENI 5**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Konsulencë, planifikim dhe organizim i ceremonive martesore.

#### **KREU II**

#### **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMI**

#### **NENI 6**

#### **KAPITALI**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë, i përbërë nga një 1 kuotë me vlerë 100 (njëqind) lekë.

#### **NENI 7**

#### **KONTRIBUTET**

Ortaku themelues Znj.Sally Sephora zotëron 100% të kapitalit.

Kontributi i ortakut është në para.

#### **NENI 8**

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë i takon ortakut themelues në masën 100%.

#### **NENI 9**

#### **TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të transferohen me anë aktesh mes të gjallëve dhe me trashëgimi. Transferimi i kuotave të kapitalit të shoqërisë nuk i nënshtrohet asnje lloj kufizimi, nëqoftëse ndodh ne rast vdekjeje.

#### **KREU III**

*Sally Sephora*

## MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISË

### NENI 10

#### ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Asambleja e ortakëve organizon, drejton dhe kontrollon gjithë aktivitetin e shoqërise. Ortaku përballon humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij.

### NENI 11

#### DREJTIMI I SHOQËRISË

Organi më i lartë drejtues i shoqërisë do të jetë asambleja e ortakëve. Asambleja e ortakëve mbledhet si rregull dy here në vit, si dhe sa herë që gjykohet e arsyeshme.

### NENI 12

#### KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË ORTAKËVE

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a.përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b.ndryshimet e statutit;
  - c.emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - d.percaktimin e shpërblimeve për personat e permendur në shkronjën "c"
  - dh.mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e.miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f.zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - g.pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - h.përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - i.riorganizimin dhe prishjen e shoqërise;
  - j.miratimin e rregullave dhe procedurave të mbledhjeve të asamblesë;
  - d.çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 2.Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "f" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

*Selly Sphora*

### NENI 13

#### ADMINISTRATORI

Shoqëria do të administrohet nga administratori Z.Lulzim Zefaj i biri i Gjergj dhe Leze, lindur dhe banues në Koplik, Fshati Kamicë, i pajisur me pasaporte nr.BR0168700 dhe numër personal H605100640 madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar me afat emërimi 5 vite.

### NENI 14

#### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqërisë emërohet nga asambleja e ortakëve dhe përgjigjet për zbatimin e vendimeve të asamblesë së ortakëve. Afati i emërimit në detyrë i administratorit do të jetë 5 vite Administratori ka këto kompetenca :

- a.Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b.Të përpilojë dhe nënshkruajë kontratat dhe aktet juridike që kanë të bëjnë me veprimtarinë e shoqërisë.
- c.Të hapi llogari rrjedhëse bankare pranë bankave shqiptare ose të huaja.
- d.Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.
- e.Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- f.Të përgatisi dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- g.Të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- h.Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rendësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- i.Të bëjë gjithcka tjetër që konsideron të dobishme dhe që është në përputhje me formën e këtij Statuti dhe Akt Themelimi si dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, për të arritur qëllimin dhe objektin e shoqërisë.

*Lulzim Zefaj*

**LIBRAT E LLOGARISË, PASQYRAT FINANCIARE, FITIMI, SHPËRNDARJA DHE  
LIKUJDIMI**

**NENI 15**

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabël që kërkon legjislacioni në fuqi edhe këto libra:

- 1- Libri i ortakëve, në të cilin shënohen emrat e plotë të Ortakëve dhe kuotat që secili ka në kapitalin e themelimit.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të asamblesë.
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të Administratorit
- 4- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të organit sindikal.

**NENI 16**

**VITI FINANCIAR**

Cdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë financiar do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë si person juridik dhe do të perfundojë me 31 Dhjetor 2024.

**NENI 17**

**FITIMET**

Fitime neto të shoqërisë do të konsiderohen fitimet që rezultojnë pas zbritjes nga të ardhurat e të gjitha shpenzimeve që kanë lidhje me aktivitetin e shoqërisë, detyrimet fiskale, shoqërore, dëmet, amortizimet, etj. në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**NENI 18**

**PRISHJA E SHOQËRISË**

Shoqëria priset me kalimin e afatit të caktuar në statut dhe për arsye të parashikuara në ligj. Shoqëria priset përpara afatit me vendim të Asamblesë së ortakëve.

**NENI 19**

Rastet e pavlefshmërisë së shoqërisë ose të një akti që ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqërisë bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit.

*Shelby Sephora*

#### **NENI 20**

Kur shoqëria prishet ajo kalon në likujdim dhe në këtë rast emërtimit të shoqërisë i shtohet shënimi "Shoqëri në likujdim e sipër". Shoqëria edhe gjatë procesit të likujdimit vazhdon si person juridik deri në përfundimin e procesit të likujdimit. Prishja e shoqërisë është me pasojë ndaj të tretëve vetëm pas publikimit të prishjes në regjistrin tregtar.

#### **NENI 21**

Kur shoqëria likujdohet, pasuritë që janë venë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, u kthehen pronarëve.

Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë dhe fondet fillestare ndahen ndërmjet ortakeve në përpjestim me kuotat e vena pasi të jenë likujduar kreditorët.

#### **NENI 22**

##### **DISPOZITA TË FUNDIT**

Shoqëria ka të drejtë të punësojë punonjës që i nevojiten për të ushtruar veprimtarinë e saj. Punësimi bëhet sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin e punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe rregullave të vena në kontratën e vecantë të punësimit që lidhet midis punëdhënësit e punonjësit.

Të gjitha problemet që do të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të kësaj shoqërisë do të zgjidhen sipas rregullave të përcaktuara në statutin dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Kur mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e shkallës së parë Tiranë.


#### **NENI 23**

Ky statut firmoset me vullnetin e lirë të ortakut themelues.

##### **ORTAKU THEMELUES**

**Sally SEPHORA**

---



SALLY SEPHORA